



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE

Kom.Dh.Shk.II.nr.1257/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen përmbare të kreditorit F... sh.p.k, me seli në Magjistralen Varosh – Ferizaj, me pronare A.F..., ndaj debitorit “...” sh.p.k, me seli në Vërmicë- Prizren, me pronar I.P., përfaqësuar sipas autorizimit nga Bestar Kolgeci, avokat në Prizren, për shkak të borxhit, në bazë të dokumentit të besueshëm, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.19/2021 të dt. 14.07.2021, jashtë seancës me datën 24.08.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit debitorit sh.p.k, me seli në Vërmicë-Prizren, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.19/2021 të dt. 14.07.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar, PPP.nr.19/2021 të dt. 14.07.2021, ka vendosur si në vijim: I. Refuzohet si i pa bazuar prapësimi i debitorit të përmbaremit sh.p.k, me seli në Vërmicë–Prizren, i ushtruar kundër urdhrit për përmbaremit P.nr.275/2020 të dt.22.11.2020, të përmbaremit privat Sheremet Livoreka nga Kaçaniku dhe i njejtë urdhër për përmbaremit mbetet në fuqi. II. Secila palë i bartë shpenzimet e përmbaremit në këtë çështje juridike të përmbaremit përveç se deri në përfundimin e procedurës në këtë çështje juridike të përmbaremit, të gjitha shpenzimet e përmbaremit, do ti bartë ajo palë e cila humbë procesin gjyqësor përmbaremit.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të shkeljeve esenciale me rendësi të procedurës përmbaremit, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, që ta aprovoj ankesën e debitorit si të bazuar dhe propozimin për përmbaremit P.nr.275/20 të dt. 22.12.2020, ta refuzoj në tërësi.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për procedurën përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori F... sh.p.k, me seli në Magjistralen Varosh – Ferizaj, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit sh.p.k, me seli në Vërmicë-Prizren, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës të dt. 08.09.2020, për shumën e detyrimit në vlerë prej 16.340.00 euro, me kamatë ligjore prej ditës së parashtrimit të propozimit deri në pagesën definitive. Si dhe shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Përmbaruesi Privat Sheremet Livoreka, me seli në Kaçanik, me Urdhrin Përmbarimor P.nr.275/20 të dt.22.10.2020, ka caktuar përmbarimin, duke vlerësuar se dokumenti i besueshëm – fatura e lartcekur, i plotëson kushtet për përmbarim.

Ndaj këtij urdhri me dt. 12.01.2021, ka paraqitur prapësim debitorit, me propozim që të shfuqizohet në tërësi urdhri i lartcekur, me të cilin është lejuar përmbarimi në bazë të faturës nr..... të lëshuar nga kreditori, duke e refuzuar në tërësi propozimin për përmbarim dhe duke e obliguar palën ti paguaj shpenzimet procedurale. Përgjigje në prapësim ka paraqitur i autorizuari i kreditorit, me dt.14.01.2021, me të cilin ka theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit në prapësim, andaj i ka propozuar gjykatës që ta hedh poshtë prapësimin si të pa bazuar si dhe të obligohet debitorit edhe në pagimin e shpenzimeve procedurale në tërësi duke përfshirë edhe për përpilimin e përgjigjes në prapësim, në shumë prej 324 eurove sipas TOA –së.

Gjykata Themelore në Prizren, me aktvendimin e atakuar, PPP.nr.19/2021 të dt. 14.07.2021, ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur me decidivisht sikur në dispozitiv të të njëjtit.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se kreditorja e përmbarimit propozimin për përmbarim e ka bërë për përmbarimin e dokumentit të besueshëm – faturës nr....., të dt. 08.09.2020, për shkak të borxhit të pa paguar në të holla në shumën prej 16.340.00 në emër të punëve të kryera sipas kontratës si dhe shpenzimeve të përmbarimit, e me propozimin e mjeteve gjegjëse të përmbarimit të parapara sipas LPP –së për realizimin e detyrimit në të holla, si në rastin konkret. Ka shtuar se në kuadër të asaj bazë mbi çfarë caktohet përmbarimi, se çka përben dokumenti i përmbarimit dhe mënyrën e zbatimit të faturës si dokument i besueshëm bëhet fjale në nenin 21, 22 par 1 pika 9, 29, 27, 30, 40 dhe nenit 37 të LPP –së, e në rastin konkret dokument i përmbarimit janë faturat përkatëse si njëra nga llojet e dokumenteve të besueshme të përmbarimit dhe propozimit për përmbarim. Ka shtuar se dokumenti i besueshëm – fatura i përmban të gjitha të dhënat të cilat duhet ti kenë dokumentet në fjalë.

Pretendimet e debitorit në prapësim i ka vlerësuar si të pa bazuara, ngase fatura për të cilën kërkohet përmbartimi i plotëson të gjitha kushtet ligjore për përmbartim, duke përfshirë edhe datën e pagesës e që është muaji shtator 2020 dhe se fatura rrjedh nga kontrata për kryerjen e projektit për legalizimin e objektit, është e nënshkruar nga të dy palët dhe përmban të gjitha elementet të cilat duhet ti ketë dokumenti i përmbartimit. Ka shtuar se meqenëse pala debitori prapësimi të saj nuk i ka bashkangjitur asnjë provë të vetme që të aprovohet prapësimi, ndërsa edhe pse njëra nga shkaqet e prapësimi konsiston në shkaqet nga neni 71 i LPP –së, të njëjtin e ka vlerësuar si të pa bazuar, andaj edhe ka vendosur si në dispozitiv.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Dhoma e shkallës së dytë nuk i ka pranuar pretendimet ankimore për shkelje të dispozitave të ligjit të procedurës përmbartimore, pasi që gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga ndërgjyqësit, ka vendosur drejtë në dispozitiv të aktvendimit, duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar dhe drejtë ka aplikuar edhe Ligjin e Procedurës Përmbartimore, përkatësisht neni 29 par 1. nën par.1.3 dhe par 3 i cili përcakton se: *“ Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: fatura. Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar ”*. Gjithashtu neni 37 dhe 40 par.1 pika 3 i LPP-së, përcakton se propozimi për përmbartim në bazë të dokumentit të besueshëm duhet të përmbajë *“originalin apo kopjen e vërtetuar e dokumentit të besueshëm”*, e në rastin konkret fatura po ashtu edhe propozimi i përmban të gjitha elementet e kërkuara nga dispozitat e lartpërmendura, andaj si i tillë dokumenti i besueshëm përmban tiparet e nevojshme të përmbartueshmërisë të përcaktuar sipas dispozitave të Ligjit të Procedurës Përmbartimore. Debitori në prapësim nuk ka ofruar ndonjë argument apo provë me të cilën kishte me paraqitur ndonjë nga shkaqet që janë të parapara me nenin 71 të LPP-së.

Duke u mbështetur në nenin 69 par.4 të LPP *“baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”*, me çka debitori nuk ka ofruar ndonjë provë për të vërtetuar të kundërtën e kreditorit, por edhe pretendimet e vetë debitorit në prapësim.

Dhoma e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale, i vlerësoi të gjitha pretendimet ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbartimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore

eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes së përmbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt pranë gjykatës kompetente, ngase një pretendim i tillë, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përmbarimit në këtë rast.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pabazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore. Andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit dhe e ka lejuar urdhrin për caktimin e përmbarimit të Përmbaruesit Privat, P.nr.275/2020 të dt.22.11.2020.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e shkallës së dytë

Kom.Dh.Shk.II.nr.1257/22 dt. 24.08.2022

Gjyqtari,
Krenar Berisha